



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 21.11.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË MINISTRISË SË
SHËNDETËSISË
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit Sabile Musa, anëtarët e ekipit Ylber Sadiku dhe Fjolla Bakalli-Sadiku, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Bujar Bajraktari.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	14
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	33
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	34
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	36
Shtojca IV: Letër e konfirmimit	42

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Auditimit, të datës 20/10/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Shëndetësisë.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Megjithatë ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se informatat e shpalosura në pasqyrat financiare, në lidhje me pasuritë dhe stokun farmaceutik nuk ishin të sakta.

Për më gjerësisht shih pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Ministrin dhe stafin e tij për bashkëpunimin gjatë procesit të auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Ministrisë - auditimi 2016**

Ministri i ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet si dhe është zotuar se do t'i implementojë rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194, dhe Rregulloren e MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksim i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se informatat e shpalosura në PFV rreth pasurive dhe stoqeve nuk janë të sakta. Kjo ka ndodhur për shkak se:

- MSh nuk i ka mirëmbajtur regjistrat e pasurive në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe si rezultat i kësaj, blerjet e pajisjeve dhe ndërtimet e financuara për organizatat tjera buxhetore, në vlerë prej 3,220,848€¹ nuk janë regjistruar si investime në vijim;
- Pasuritë e blera në vitin 2016 nga Agjencia Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM) në vlerë 101,180€, dhe renovimi për ndarjen e dhomave në objektin e Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut (QKKTGj) në vlerë 3,626€ nuk janë regjistruar në regjistrin e pasurive;
- Vlera e pasurive jo kapitale (me vlerë nën 1,000€), e shpalosur në PFV ishte nënvlerësuar për 43,846€, si pasojë e mos regjistrimit të pasurive në e-pasuria (shih në detaje çështjen 24); dhe
- Nuk janë shpalosur fare informata në lidhje me stoqet e barnave nga lista esenciale, për shkak se Agjencioni i Financimit Shëndetësor (AFSh) nuk ka qenë në gjendje të siguroj informata lidhur me gjendjen e furnizimit të barnave. Informatat për stokun farmaceutik të shëndetit primar janë siguruar pas dorëzimit të PFV-ve të korrigjuara, ndërsa nuk kishte evidenca për barnat për shëndetin sekondar dhe terciar, ngase nuk bëhet monitorimi, dhe nuk bëhen barazime me Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK).

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i MSh-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194.

Ministri dhe Sekretari i Përgjithshëm janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të, në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

¹ Ndërtimin e QMF në Bair Mitrovicë në vlerë 70,000€; Ndërtimin e klinikës emergjente në QKUK në vlerë 1,689,070€; Blerja e pajisjeve për Klinikën e Endokrinologjisë në QKUK në vlerë 14,400€, aparat biokimik për QKMF në Obiliq në vlerë 14,900 euro si dhe 2 karrige stomatologjike në vlerë 17,400€ në kuadër të projektit "Përkrahje e komunitetit RAE"; Furnizim me autoambulancë dhe automjete në vlerën prej 226,830 euro; Furnizim me pajisje mjekësore për QKMF në Podujevë në vlerë 62,000€; pajisje mjekësore për Spitalet Regjionale nga Huamarrja në vlerë prej 1,097,328€; si dhe Pajisjet mjekësore që përfshinë që përfshinë 2 karrige stomatologjike, 7 defibrilator dhe një rengen dental të blera për qendrat e shërbimeve të burgjeve në vlerë 28,920€.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

MSh kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Pasqyrat Nëntëmujore Financiare; dhe
- Planin Përfundimtar të prokurimit.

Në kontekst të PFV-ve, nuk kemi çështje materiale për të ngritur. Çështjet e ngritura në Memorandumin e Auditimit, të datës 20/12/2016, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga menaxhmenti, megjithatë ekziston një numër i gabimeve:

- Vlera e prezantuar në PFV për llogaritë e arkëtueshme ishte 252,620€. Mirëpo kjo vlerë është e nënvlerësuar për 209,969€ për shkak se nuk ishin përfshirë llogaritë e arkëtueshme të Inspektoratit të Shëndetësisë në vlerë 120,620€, të Inspektoratit Farmaceutik 18,000€, dhe

llogaritë e arkëtueshme të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik në vlerë 71,349€, të cilat i takojnë periudhës para vitit 2016;

- Vlera e prezantuar në PFV për obligimet e papaguara ishte 2,501,287€ prej tyre 2,023,253€ janë obligime të papaguara për furnizim me barna nga kategoria e mallrave dhe shërbime të cilat janë nën menaxhimin e AFSH-së. Megjithatë ne nuk kemi qenë në gjendje të marrim siguri se vlera e shpalosur e obligimeve është saktë për arsye se aty janë përfshirë edhe katër (4) fatura të janarit 2017 (me vlerë 281,052€), dhe pesë (5) fatura të vitit 2015 (me vlerë 257,775€);
- Vlera e stoqeve të barnave nuk është prezantuar fare në PFV, për shkak të vonesës së informatave nga departamenti përkatës; dhe
- Në PFV nuk janë shpalosur informata rreth pasurive që janë blerë dhe ndërtuar për organizatat tjera buxhetore.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë, ndonëse ekzistojnë gabime, por që nuk ndikojnë në modifikimin e opinionit të auditimit.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjet e sipërpërmendura jepen rekomandimet:

Rekomandimi 1 Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë detajuar e pikave të ngritura tek Theksimi i Çështjes për t'i përcaktuar shkaqet e paraqitjes së tyre. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për ta siguruar regjistrimin dhe vlerësimin e saktë të pasurive kapitale. Pasuritë jo financiare të blera/ndërtuara për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në kategorinë e investimeve në vijim deri në përfundimin e procedurave të dorëzimit dhe bartjes së pronësisë. Po ashtu AFSH duhet të mbaj evidencat dhe të bëjë barazimet me ShSKUK, në lidhje me furnizimet me barna dhe material mjekësor. Vlera e saldoeve përfundimtare të stoqeve duhet të shpaloset në PFV.

Rekomandimi 2 Ministri duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2017 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo duhet të përfshijë edhe rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MSh-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Edhe pse MSh ka bërë përmirësime në qeverisje, ende mbetin një numër fushash ku nevojiten zhvillime të rëndësishme, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut, organizimin e brendshëm dhe qartësimin e përgjegjësisë në mes të MSh-së dhe ShSKUK-së. Pyetësi i vet-vlerësimit, i plotësuar nga MSh, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi aranzhimet ekzistuese në lidhje me fushat e cekura më lartë, por të cilat nuk janë të mbështetura me dëshmi. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi të auditimit të brendshëm të cilësisë së lartë, janë të vendosura dhe sqarimet jepen në vazhdim të këtij raporti.

MSh ka bërë përpjekje për adresimin e rekomandimeve të vitit të kaluar, duke përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, ku janë përcaktuar afatet kohore dhe bartësit e aktiviteteve. Megjithatë një pjesë e rekomandimeve janë zbatuar vetëm pjesërisht sepse zbatimi i këtij plani nuk ishte monitoruar formalisht. Zbatimi i plotë i rekomandimeve të dhëna nga Auditori i Përgjithshëm (AP) edhe më tutje mbetet sfida.

Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 të MSh-së ka rezultuar në 25 rekomandime. MSh kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet. Mirëpo ky plan nuk është mbështetur me një proces konfirmues ku zbatimi i rekomandimeve do të monitorohej formalisht.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, vetëm një (1) rekomandim ishte zbatuar plotësisht; 11 janë në proces të zbatimit dhe 13 nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 3 – Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

- E gjetura** Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar sepse MSh nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së.
- Rreziku** Mos zbatimi i rekomandimeve të AP-së ka ndikuar që të përsëriten dobësi të vazhdueshme të kontrolleve në sistemet financiare kyçe, si menaxhimi i pasurive, pagesat për specializantë, monitorimi i shpenzimeve për furnizim me barna, paga dhe mëditje dhe të hyra. Kjo ka ndikuar që shumë nga rekomandimet e AP-së të përsëriten.
- Rekomandimi 3** Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vet-vlerësimit për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorit, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të tij. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për MSh-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin Vjetor të Auditimit.

Çështja 4 - Pyetësi i vet-vlerësimit - Prioritet i lartë

- E gjetura** Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë (5) komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:
1. Pyetësi i vet-vlerësimit i plotësuar ka vërtetuar se MSh ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të vlerësimit dhe menaxhimit të rreziqeve. Megjithatë deri në fund të auditimit tonë nuk ishte bërë vlerësimi, monitorimi dhe azhurnimi i regjistrit të rrezikut;
 2. Proceset efektive të monitorimit si dhe strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit konsiderohen si të vendosura nga MSh;
 3. Pyetësi i vet-vlerësimit, potencon se MSh ka rregulloren për organizim të brendshëm. Megjithatë kjo rregullore nuk është e përshtatshme, pasi në dy vitet e fundit kanë ndodhur disa ndryshime dhe ende nuk është miratuar një rregullore dhe strukturë organizative e re për t'iu përshtatur rrethanave të reja, dhe
 4. Lidhja e planit të prokurimit me buxhetin nuk ishte bërë plotësisht, pasi që plani i prokurimit ishte i mangët, dhe nuk i ka përfshirë të gjitha aktivitetet e prokurimit që janë zhvilluar gjatë vitit.
- Rreziku** Aranzhimet e dobëta të qeverisjes sa i përket organizimit të brendshëm dhe harmonizimi i dobët i planit të prokurimit me buxhetin, ndikojnë në dobësimin e proceseve strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.
- Rekomandimi 4** Ministri duhet të sigurojë se është rishikuar procesi i plotësimit të pyetësit të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave ku janë evidentuar mangësi. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e përgjigjeve të dhëna në pyetësor si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar në planifikimin e auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit MSh operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

MSh ka një numër të njëjësive vartëse, si: AKPPM, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShP), AFSH dhe QKKTGj, të cilat janë të obliguara të përgatisin PFV-të e tyre, të cilat pastaj konsolidohen në PFV-të e MSh-së. Për të siguruar një menaxhim financiar efektiv nevojitet një proces efektiv i konsolidimit të informatave, si dhe raportim cilësor dhe me kohë nga të gjitha njësitë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre (3) anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe dy (2) auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet e MSh-së dhe i cili ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohej nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet i Auditimit (KA) efektiv.

Çështja 5 - Mos zbatim i rekomandimeve të NjAB-së - Prioriteti i lartë

E gjetura NjAB ka planifikuar t'i kryej 14 auditime të rregullta dhe një me kërkesë. Për vitin 2016 plani ishte realizuar 100%. Raportet ishin cilësore dhe të dëshmuara në mënyrë adekuate ku kishin mbuluar aktivitetet e vitit 2015 dhe 2016. Megjithatë rekomandimet e auditimit të brendshëm nuk janë zbatuar plotësisht nga njësitë që kanë qenë subjekt i auditimit.

Kjo rezulton nga mungesa e vëmendjes së Menaxhmentit në njohjen dhe maksimizimin e përfitimit të auditimit të brendshëm ose për të kërkuar siguri për funksionimin efektiv të kontroleve të brendshme.

Rreziku Mos adresimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm ndikon që dobësitë e evidentuara të përsëriten, dhe humbet mundësia për të përmirësuar proceset dhe sistemet brenda ministrisë.

Rekomandimi 5 Ministri duhet të sigurojë një rishikim të veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm. Duhet të ndërmerren veprime shtesë për të siguruar zbatimin e plotë të rekomandimeve të NjAB-së.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në MSh. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Sa i përket MSh-së, ekzekutimi i buxhetit për Investimet Kapitale mbetet shqetësim kryesor, ku janë duke u shpenzuar mjete për pajisje dhe ndërtime për organizatat tjera buxhetore, mirëpo mungojnë evidencat në lidhje me to në regjistrat e pasurive, keq-klasifikimi i shpenzimeve pasi që shpenzimet për mirëmbajtje dhe servisim, janë trajtuar si investime kapitale përderisa ato nuk i përmbushin kushtet të trajtohen si projekte kapitale.

Fushat tjera ku nevojitet më shumë përmirësim janë menaxhimi i subvencioneve, menaxhimi i buxhetit për barna, menaxhimi i pasurive, pagat dhe mëditjet dhe menaxhimi i evidencave për të hyrat.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	2,410,000	2,410,000	4,923,661	3,432,782	3,045,358
Totali	2,410,000	2,410,000	4,923,661	3,432,782	3,045,358

Të hyrat vetjake prej 146,783€ ishin lejuar të shpenzoheshin për nevojat e MSh-së. Pjesa tjetër janë transferuar në Buxhetin e Kosovës. Totali i të hyrave të arkëtuara reflekton një rritje të vazhdueshme të realizimit të të hyrave krahasuar me vitet e kaluara.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	55,404,900	52,921,662	49,774,144	31,698,422	27,420,111
Financimi nga Huamarrja	4,634,239	5,234,239	3,723,345	56,737	0
Granti i Qeverisë -Buxheti	50,770,661	46,190,635	45,671,695	31,390,978	26,752,800
Të bartura nga viti paraprak ³ -		59,151	59,151	100	387,425
Të hyrat vetjake ⁴		146,783	529	10,149	48,878
Donacionet e jashtme		1,290,854	319,425	240,459	231,009

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 2,483,238€. Kjo është rezultat i zvogëlimit të grantit qeveritar për 4,580,026€, me rishikim të buxhetit dhe me vendime të mëvonshme të qeverisë. Ndërkohë që buxhetit i janë shtuar 600,000€ nga huamarrja, 1,290,854€ nga donacionet e jashtme dhe 205,934€ nga të hyrat vetjake dhe të hyrat e bartura.

Në vitin 2016, MSh ka përdorur 94% të buxhet final ose 49,774,144€, me një përmirësim prej 10% krahasuar me vitin 2015. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	55,404,900	52,921,662	49,774,144	31,698,422	27,420,111
Pagat dhe Mëditjet	8,722,755	8,090,868	7,940,750	7,652,757	6,918,642
Mallrat dhe Shërbimet	26,475,872	25,898,361	24,661,108	9,145,047	8,913,743
Shërbimet komunale	230,548	193,366	183,845	195,857	172,515
Subvencionet dhe Transferet	7,503,725	9,947,155	9,841,961	9,714,570	9,683,042
Investimet Kapitale	12,472,000	8,791,912	7,146,481	4,990,190	1,732,169

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte reduktuar për 631,887€. Reduktimi ka ndodhur me rishikim të buxhetit;
- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte reduktuar për 577,511€. Prej tyre 82,800€ ishin transferuar në buxhetin e ShSKUK-së për investime kapitale. Pjesa tjetër është zvogëluar si rezultat i rishikimit të buxhetit, për arsye të vonësive në adresimin e kërkesave me kohë, që bëhen nga ShSKUK-ja për furnizim me barna;

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të MSh të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

-
- Buxheti për shërbime komunale ishte reduktuar për 37,182€, si rezultat i rishikimit të buxhetit;
 - Buxheti për subvencione dhe transfere ishte rritur për 2,443,430€. Rritja e buxhetit ka ndodhur me rishikim të buxhetit dhe në fund vit për punësimin e Specialistëve dhe shkollimin Specialist, si dhe për Trajtimin Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (TMJISHP); dhe
 - Buxheti për investime kapitale ishte reduktuar për 3,680,088€, për arsye të vonësive në realizimin e projekteve. Kjo mund të shihet edhe nga dinamika e shpenzimeve ku 74% e shpenzimeve janë realizuar në tre muajt e fundit. Shpenzimet e përqendruara në muajt e fundit shtojnë rrezikun që fondet të shpenzohen në mënyrë joefikase, duke qenë se fokusi është më shumë i vendosur në arritjen e nivelit të dëshiruar të shpenzimeve sesa në rezultatet efektive.
-

Çështja 6 – Keq klasifikim i shpenzimeve- Prioriteti i lartë

E gjetura	Në IKShP dhe QKKTGj shpenzimet për mirëmbajtje dhe servisim të aparaturave mjekësore ishin realizuar nga kategoria e investimeve kapitale si rezultat i buxhetimit të gabuar të tyre në këtë kategori. Ne kemi identifikuar shpenzime të tilla në vlerë 33,091€ në IKShP dhe 11,220€ në QKKTGj. Ky klasifikim është në kundërshtim me Rregulloren për klasifikimin e shpenzimeve dhe rregulloren për menaxhimin e pasurisë jo financiare.
Rreziku	Buxheti i shpenzimeve në kategori të gabuara ndikon në paraqitjen jo të drejtë të gjendjes reale të tyre në pasqyrat financiare duke shkaktuar kështu mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive adekuate.
Rekomandimi 6	Ministri dhe Drejtorët e Njësive të MSh-së duhet të sigurojnë që shpenzimet të buxhetohen dhe realizohen konform kodeve ekonomike adekuate të parapara me legjislacionin në fuqi, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga MSh në 2016 ishin në vlerë 4,923,661€. Ato kanë të bëjnë me: të hyrat nga licencat për produkte medicinale, banderolat, autorizimet e marketingut, participimet nga pacientët, të hyrat nga provimet specialistike, librezat sanitare, gjobat e lëshuara nga Inspektoriat Shëndetësor etj.

Çështja 7 – Menaxhimi i procesit të grumbullimit dhe regjistrimit të të hyrave – Prioritet i lartë

- E gjetura** Në MSh ende nuk është funksionalizuar moduli për të hyra në Sistemin e Informimit Shëndetësor (SISh), përmes të cilit do të evidentohet realizimi dhe raportimi i të hyrave. Barazimet për të hyrat e regjistruara nga njësitë dhe departamentet brenda ministrisë bëhen çdo muaj me Koordinatorin e të hyrave në nivel të Ministrisë e cila pastaj kryen barazimet e rregullta me Thesarin. Mirëpo koordinatorja e të hyrave nuk mban regjistër analitik të të hyrave për të gjitha programet e MSh-së. Të dhënat analitike i mbajnë vetëm zyrtarët përkatës nëpër programet në të cilat realizohen të hyrat.
- Rreziku** Menaxhimi jo i duhur i procesit të grumbullimit dhe regjistrimit të të hyrave mund të shkaktojë diferenca gjatë barazimeve brenda programeve të ministrisë të cilat si pasojë do të reflektoheshin edhe në barazimet e rregullta me Thesarin. Procesimi aktual i informatave për të hyrat duke mos e përdorur modulin e të hyrave në SISh, mund të sjell deri tek gabimet dhe marrjen e vendimeve në mungesë të informatave të sakta.
- Rekomandimi 7** Ministri duhet që të sigurojë respektimin e kërkesave ligjore në lidhje me procesin – menaxhimin e të hyrave duke ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që njësitë vartëse të bëjnë regjistrimin e të hyrave në SIMFK. Po ashtu duhet të vihet në diskutim çështja e funksionalizimit të modulit të të hyrave në kuadër të SISh-it. Kjo do të mbështeste mbledhjen dhe menaxhimin e informatave rreth të hyrave.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe që zbatohen në MSh dhe njësitë vartëse të saj, kanë të bëjnë me konfirmimin e saktësisë dhe plotësinë e pagesave. Po ashtu këtu përfshihet llogaritja dhe aprovimi i kompensimeve për kujdestaritë e mjekëve në specializim dhe kompensimet tjera.

Çështja 8 - Kompensimi i kujdestarive të mjekëve në specializim në kundërshtim me UA - Prioritet i lartë

E gjetura Me vendim të Ministrit ishin kompensuar për kujdestaritë e mbajtura, mjekët në specializim të rregullt që paguhen përmes listës së pagave. Shuma e kompensuar për vitin 2016 për këtë kategori të specializantëve ishte 68,579€. Mirëpo në kemi vërejtur se ky vendim është në kundërshtim me Udhëzuesin Administrativ për Shkollimin Specialistik dhe Subspecialistik, sipas të cilit së paku dy (2) kujdestari brenda muajit janë të obligueshme për plotësimin e programit për të cilin kompensohen specializantët. Obligimet që dalin nga ky UA dhe që duhet përmbushur nga specializantët janë theksuar edhe në kontratat individuale, të nënshkruara prej tyre. Kompensimi është bërë në bazë të listës përmbledhëse mujore për kujdestaritë e mbajtura, të dërguara për pagesë nga ShSKUK-ja në MSh. Mirëpo raportet e ofruara për dokumentimin e kujdestarive të mbajtura nuk ofrojnë mbështetje të mjaftueshme pasi së paku në pesë (5) raste, mungonte nënshkrimi i specializantit që ka mbajtur kujdestari.

Rreziku Kompensimi i specializantëve në kundërshtim me rregulloret e aplikueshme dhe në mungesë të dëshmive relevante, dëmton buxhetin e ministrisë.

Rekomandimi 8 Ministri duhet të sigurojë se do të rishikohet vendimi për kompensimin e kujdestarive, në mënyrë që ai të jetë, i bazuar dhe në përputhje me kërkesat e aplikueshme ligjore.

Çështja 9 - Kompensimi i punëtorëve që nuk janë staf i MSh-së - Prioritet i mesëm

E gjetura Në MSh vazhdojnë të jenë në listë të pagave 24 mjek specialistë që janë në marrëdhënie pune me ShSKUK-në, e cila që nga viti 2015 është Organizate Buxhetore e veçantë. Kompensimi për këtë kategori është i buxhetuar në kuadër të programit të Aftësimin Specialistik.

Rreziku Kompensimi i stafit i cili nuk është staf i MSh-së rezulton me shpenzim të pa arsyeshëm të buxhetit dhe ndikon negativisht në planin e shpenzimeve duke pamundësuar destinimin e mjeteve për objektiva tjera të MSh-së.

Rekomandimi 9 Ministri së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm të ShSKUK-së duhet të shqyrtojnë mundësinë që kompensimi për pagat e mjekëve specialist të bëhet nga buxheti i ShSKUK e jo nga Ministria.

Çështja 10 – Kompensimi në mungesë të dokumentit që vërteton punësimin – Prioritet i mesëm

- E gjetura** E punësuara në pozitën Shefe e Njësisë për furnizim në departamentin farmaceutik në MSh është identifikuar në listën e pagave në kuadër të Administratës Qendrore të MSh-së edhe pse kontrata e saj ka skaduar në prill të vitit 2013. “Ligji për Shërbimin Civil” përkatësisht Neni 96 dhe 97 përcaktojnë qartë afatin dhe kushtet e zëvendësimit të kontratave të punës të Shërbimit Civil me shkresa të emërimit pa afat. Një konfirmim i tillë i punësimit nuk ka ndodhur me rastin e identifikuar pasi nuk është nënshkruar akti i emërimit. E punësuara kompensohet me 50% të pagës si rezultat i pezullimit për çështje gjyqësore në prill të vitit 2014.
- Rreziku** Kompensimi i stafit në mungesë të kontratës/akt-emërimit valid, është në kundërshtim me ligjin dhe rregulloret e shërbyesve civil dhe mund të rezultojë me pagesa të parregullta dhe dëmtim të buxhetit.
- Rekomandimi 10** Ministri duhet të sigurojë që çdo i punësuar që përfiton pagë në kuadër të MSh-së, të ketë dokument valid që vërteton marrëdhënien e punës dhe dosjen e kompletuar siç parashihet me kornizën ligjore.

Çështja 11 – Mbajtja e pozitave kyçe me ushtrues detyre dhe marrëdhënie sekondare të punës – prioritet i mesëm

- E gjetura** Ligji për Shërbimin civil të Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-149), përkatësisht Neni 30.4, precizon që për plotësimin e pozitës së lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës (UD) nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj. Ne kemi gjetur se në MSh pesë (5) pozita udhëheqëse vazhdojnë të mbahen nga UD duke e tejkalluar afatin e lejuar ligjor për mbajtjen e pozitës në këtë formë.
- Në IKShPK 14 pozita udhëheqëse vazhdojnë të mbahen me kontrata për punë sekondare, ngase mbajtësit e këtyre pozitave, pagë primare kanë nga një organizatë tjetër buxhetore.
- Rreziku** UD në periudhë më të gjatë se tre (3) muaj është në kundërshtim me ligjet e aplikueshme dhe mund të ndikoj në performancën operationale të entitetit. Pozitat menaxheriale me pagë sekondare po ashtu shkaktojnë rezultate jo të mira në punë pasi për udhëheqjen e pozitave drejtuese kërkohet angazhim i plotë kohor.
- Rekomandimi 11** Ministri dhe drejtori i IKShP-së duhet të sigurojnë që të gjitha pozitat udhëheqëse të ushtrohen me orar të plotë dhe me kontrata të rregullta të punës. Kësaj duhet ti paraprijë konkursi publik i zhvilluar në pajtim me rregullat në fuçi.

Çështja 12 – Angazhimi i stafit me kontrata për shërbime të veçanta për pozitat e rregullta të punës – Prioritet i mesëm

E gjetura MSh vazhdon të angazhojë staf me kontrata për shërbime të veçanta, të cilët angazhohen pa procedura të rregullta të rekrutimit. Duke ju referuar të dhënave në PFV për vitin 2016, MSh ka raportuar gjithsej 28 raste me kontrata të tilla prej të cilëve 12 i takojnë AKPPM-së. Ata paguhen nga mallrat dhe shërbimet dhe kohëzgjatja e tyre kishte tejkalluar afatet e lejuara me ligj.

Rreziku Angazhimi i stafit me kontrata për shërbimet e veçanta, duke anashkalluar procedurat e hapura të rekrutimit, minimizon konkurrencën dhe rrit rrezikun e angazhimit të personave jo të duhur në pozitat e caktuara. Tejkalimi i kohëzgjatjes së këtyre kontratave për më shumë se gjashtë (6) muaj është në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Rekomandimi 12 Ministri duhet të inicojë një rishikim gjithëpërfshirës të rasteve në të cilat stafi është angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta për të përcaktuar saktë nevojat për staf me qëllim që të gjitha pozitat e nevojshme të plotësohen me staf të rregullt, përmes procesit të hapur të rekrutimit.

Çështja 13 – Tejkalim i numrit të stafit në Kabinetin e Ministrisë – Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas ligjit të rishikuar të buxhetit numri i paraparë i të punësuarve në kabinetin e Ministrisë ishte dhjetë (10). MSh ka tejkalluar dukshëm, përkatësisht ka dyfishuar numrin e stafit të punësuar në kabinet, në 20 vetë.

Rreziku Tejkalimi i numrit të buxhetuar të stafit paraqet planifikim jo efikas të nevojave për staf dhe ndikon në shpenzimin jo racional e buxhetit.

Rekomandimi 13 Ministri duhet të sigurojë që planifikimi i numrit të stafit të bëhet në pajtim me nevojat reale dhe numri i stafit të planifikuar me buxhet të mos tejkallohet.

Çështja 14 – Pagesa e bordeve dhe komisioneve – Prioritet i lartë

E gjetura MSh vazhdon t'i kompensojë zyrtarët e saj për angazhime në borde dhe komisione, në kundërshtim me nenin 80 të LMFPP-së. Pagesat për borde dhe komisione në MSh për vitin 2016 (përfshirë edhe dhjetorin 2015) ishin në vlerën prej 390,385€. Edhe më tej vazhdon të përsëritet pjesëmarrja e zyrtarëve të njëjtë në më shumë se një komision apo bord.

Rreziku Pagesat për borde dhe komisione për zyrtarët specifik janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi pasi që nuk lejohet pjesëmarrja në më shumë se një bord apo komision. Kjo mund të shkaktojë pagesa të parregullta dhe dëmtim eventual të buxhetit. Përveç kësaj angazhimi në borde/komisione gjatë orarit të punës rrit rrezikun që zyrtarët të mos i kryejnë obligimet e tyre ditore si rezultat i angazhimit në detyra tjera.

Rekomandimi 14 Ministri duhet të iniciojë zhvillimin e një politike të re rreth funksionimit të bordeve dhe komisioneve duke specifikuar në mënyrë të qartë udhëzimet rreth angazhimit, punës dhe kompensimit të anëtarëve të bordeve dhe komisioneve të ndryshme.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 26,091,727€ (përfshirë shërbimet komunale). Prej tyre ishin shpenzuar 24,844,953€. Rreth, 85% e buxhetit për mallra dhe shërbime ishin shpenzuar për furnizim me barna dhe material hargjues nga lista esenciale. Pjesa tjetër ka të bëjë me shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet komunale, shërbime kontraktuese, për edukim të vazhdueshëm mjekësor etj.

Çështja 15 – Përkrahje financiare nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas ligjit për shëndetësinë, Institucionet Shëndetësore janë të obliguara që të mundësojnë zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punëtorëve të tyre shëndetësor. Ne kemi vërejtur se Ministria, përmes Bordit për Edukim të Vazhdueshëm Mjekësor kishte përkrahur financiarisht disa punëtor shëndetësor të ShSKUK-së, për pjesëmarrje në aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm mjekësor. Mjetet për këto aktivitete ishin dhënë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Kjo ndodh për shkak të keq buxhetimit të këtyre mjeteve. Përveç kësaj, përfituesit, jo çdo herë i kanë mbyllur avancet me kohë duke krijuar vlerë të lartë të avanceve të pambyllura.

Rreziku Përkrahja financiare nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ndikon në mbi shpenzim të kësaj kategorie dhe nën shpenzim të kategorisë së subvencioneve. Vonesat në arsyetimin e avanceve e rrisin rrezikun e mos kthimit të mjeteve të pashfrytëzuara.

Rekomandimi 15 Ministri duhet të siguroj se përkrahja financiare të bëhet sipas rregullave të thesarit dhe se ndaj shfrytëzuesve që nuk i arsyetojnë shpenzimet janë marr masat për humbjen e të drejtës për aplikim të serishëm. Poashtu duhet të kërkohet nga ShSKUK që të gjithë personave të cilët nuk e kanë arsyetuar shpenzimin e mjeteve konform rregullave, t’iu zbatohen ndalesa në paga për vlerën e mjeteve që nuk janë arsyetuar.

Çështja 16 – Vonesa në adresimin e kërkesave për furnizim me barna – Prioritet i lartë

E gjetura

Furnizimi i barnave është percjellur me mangësitë në vijim:

- AFSH menaxhon me buxhetin për furnizim me barna, derisa kërkesat për furnizimin e tyre bëhen nga ShSKUK-ja në AFSH. Mirëpo duhet theksuar se pothuajse në të gjitha mostrat e testuara, ne kemi vërejtur se kishte vonesa të adresimit të kërkesave nga ana e AFSH-së tek operatorët ekonomik. Në pesë (5) raste për furnizim me barna kërkesat nga AFSH dhe urdhërblerja ishin bërë pas pranimin të faturës; dhe
- Në shtatë (7) raste ka pasur vonesa nga ana e operatorëve ekonomik, mirëpo nuk janë llogaritur ndëshkimet për të gjitha rastet pasi porositë për furnizim me barna janë bërë pa urdhër blerje.

Rreziku

Mos adresimi i kërkesave me kohë dhe vonesat nga operatori ekonomik për furnizim me barna, krijon vështirësi në punën e ShSKUK-së dhe zvogëlon performancën e institucioneve shëndetësore. Kur për vonesat nuk zbatohen penalet, kjo mund të rezultojë me kosto me të lartë për ministrinë.

Rekomandimi 16 Ministri duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim i procesit, për të përcaktuar shkaqet e vonesave në adresimin e kërkesave për furnizim me barna, dhe të ndërmarrë masat e nevojshme për menaxhim më të mirë të procesit të furnizimit me barna dhe material nga lista esenciale.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere në 2016 ishte 9,947,155€. Prej tyre ishin shpenzuar 9,841,961€. Ato kanë të bëjnë me: TMJISHP, subvencionimin e specializantëve – Aftësimi specialistik dhe subvencionimin e shoqatave/profesionistëve shëndetësor për Edukim të Vazhdueshëm Mjekësor (EVM). Kontrollat aktuale lidhur me menaxhimin e kësaj fushe të shpenzimeve nuk janë të kënaqshme. Rezultatet e testimit kanë rezultuar me mos respektim të rregullave financiare dhe mos respektim të kërkesave rregullative tek TMJISHP, monitorim i dobët i aftësimin specialistik dhe mos raportim nga ana e shoqatave/profesionistëve shëndetësorë për EVM, në lidhje me shpenzimin e mjeteve të përfituara nga ministria.

Çështja 17 - Trajtimi jo i rregullt i aplikacioneve për TMJIShP - Prioritet i mesëm

E gjetura Shqyrtimi jonë i mostrave nga lëmi i TMJIShP ka nxjerrë në pah mangësitë, si:

- **Mos shqyrtimi i aplikacioneve sipas radhës së arritjes** – Sipas Udhëzimit administrativ 10/2013 i plotësuar dhe ndryshuar me UA 3/2016, për TMJIShP-ve, kërkesat e pacientëve duhet të shqyrtohen sipas datës të arritjes së tyre. Mirëpo, ne kemi identifikuar se trajtimi i tyre nuk bëhet çdo herë sipas radhës. Duke pasur lëndë ende të pa shqyrtuara, Bordi Ekzekutiv kishte pranuar dhe aprovuar lëndë të reja. Përderisa për disa lëndë kohëzgjatja e shqyrtimit dhe ekzekutimit të tyre ishte më pak se një muaj, për disa të tjera ishte deri në një (1) vit. Vonesat ishin shkaktuar kryesisht tek Bordi Ekzekutiv ngase nuk kishte vonesa të theksuara në pranimin dhe shqyrtimin e tyre nga zyra për TMJISHP dhe komisioni për vlerësim mjekësor;
- **Aplikacionet e pranuar në kundërshtim me kërkesat e UA 10/2013, i plotësuar dhe ndryshuar me UA 3/2016** – Në tetë (8) raste Zyra për TMJIShP kishte proceduar për shqyrtim aplikacionet, në mungesë të pro faturave. Kjo është në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit. Po ashtu, në dy (2) raste të subvencionuara në vlerë 60,000€ raporti i komisionit konziliar ishte i nënshkruar vetëm nga dy (2) mjek, ndërsa sipas UA 10/2013 raporti duhet të jetë i nënshkruar nga tre (3) mjek. Nuk kishte ndonjë shpjegim pse kanë ndodhur këto mospërfillje të kërkesave ligjore; dhe
- **Kërkesat rregullative nuk ishin respektuar edhe në raste tjera si:** një pacient ishte kompensuar në 100% të vlerës së profaturës prej 7,850€, derisa sipas udhëzimit administrativ, ishte dashur të subvencionohej vetëm 70% të profaturës apo 5,495€; në një rast tjetër, nuk ishte kompensuar ne 100% të vlerës së pro-faturës, edhe pse lejohej; në tetë (8) raste ishin kompensuar trajtimet mjekësore pa përfunduar procedurat administrative të aplikimit, dukuri kjo në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit administrativ.

Rreziku Dobësitë e sipërpërmendura ndikojnë në efektivitetin e menaxhimit të subvencioneve. Pranimi dhe shqyrtimi i aplikacioneve, në kundërshtim me kërkesat ligjore, rrit rrezikun që pacientët jo meritore të përftojnë dhe mund të humbë efektin e ofrimit të shërbimeve në kohën e duhur.

Rekomandimi 17 Ministri duhet të sigurojë që kërkesat e udhëzimeve administrative përkatëse të respektohen gjatë procesit të aplikimit dhe shqyrtimit aplikacioneve për TMJIShP, me qëllim që të përfitojnë personat meritore dhe në kohën e duhur për të arritur qëllimin e trajtimit.

Çështja 18 - Mos arsyetim i mjeteve të dhëna për TMJIShP - Prioritet i lartë

E gjetura Mungesa e barazimeve me Institucionet shëndetësore private dhe mos sjellja e dëshmimeve nga ana e pacientëve, pas marrjes së trajtimit mjekësor kanë ndikuar që mos të ketë arsyetim të plotë për mjetet e paguara për TMJIShP.

Barazimet financiare janë kryer me vetëm gjashtë (6) nga rreth 100 institucionet private shëndetësore. Nga barazimet financiare kanë rezultuar rreth 245,760€ të cilat nuk janë shfrytëzuar për trajtimin e pacientëve, e të cilat pastaj janë ridestinuuar për pacientët tjerë. MSh nuk ka një mekanizëm adekuat për realizimin e barazimeve financiare me institucionet private shëndetësore. Përkundër veprimeve të ndërmarra në këtë drejtim, mekanizmat e ngritur për realizimin e barazimeve nuk janë të mjaftueshme për shkak të numrit të madh të institucioneve shëndetësore private.

Përveq kësaj, Ministria vazhdon të bëj pagesat për trajtim të pacientëve jashtë institucioneve shëndetësore publike duke u bazuar në pro faturat që pacientët i sjellin në kohën e aplikimit. Mirëpo pas trajtimit pacientët nuk i sjellin dëshmitë për marrjen e shërbimeve dhe faturat përkatëse për t'i arsyetuar shpenzimet edhe pse kjo kërkohet në vendimet e lëshuara nga ministria.

Rreziku Mos arsyetimi i plotë i shpenzimeve për TMJIShP, dhe mungesa e barazimeve financiare rrit rrezikun që të bëhen pagesa të parregullta dhe mund të rezultojë me shuma të mëdha të mjeteve financiare të cilat nuk janë shfrytëzuar konform qëllimeve të aprovuara.

Rekomandimi 18 Ministri duhet të sigurohet se subvencionet paguhen duke u mbështetur në marrëveshje formale në mes të MSh-së dhe përfituesit, ku qartësohen obligimet e të dy palëve. Të bëhen barazimet financiare me institucionet private shëndetësore nëse ekzistojnë mjete financiare të pashfrytëzuara, dhe nëse po mjetet e tilla të ri-destinohen.

Çështja 19 - Pagesat për shkollimin e specialistëve me vetëfinancim - Prioritet i lartë

E gjetura Duke u bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 09/2013, MSh ka subvencionuar specialistët të cilët ishin në shkollim specialistik me vetëfinancim. Përveç kontratave për specializim në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) me 40 orë punë në javë si angazhim primar, MSh përmes aneks kontratave u ka mundësuar specialistëve angazhimin prej tetë (8) orë punë në javë si angazhim sekondar në nivelin primar të shëndetësisë. Me kërkesë të ministrisë specialistët kanë nënshkruar deklaratat përmes të cilave pranojnë se nuk do të kenë angazhime tjera. Mirëpo ne kemi gjetur se 55 specialistë gjatë vitit 2016 kanë punuar edhe në institucione tjera shëndetësore (10 prej tyre në sektorin publik). Si rezultat, buxheti i ministrisë për vitin 2016 ishte dëmtuar në vlerë prej 281,652€. Përveç kësaj, ne kemi evidentuar se ministria (me vendim të Ministrisë) ju kishte kompensuar edhe nga dy kujdestari të cilat sipas kërkesave të udhëzimit për shkollimin specialistik 10/2014, specialistët janë të obliguar t'i mbajnë. Vlera e kujdestarive të kompenzuara për këtë kategori të specialistëve, për vitin 2016 ishte 86,630€.

Rreziku Mungesa e mekanizmave për monitorimin dhe verifikimin e të ardhurave të specialistëve të cilët subvencionohen nga MSh-ja rrezikon të bëhen pagesa në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe si pasojë me dëmtim të buxhetit të ministrisë.

Rekomandimi 19 Ministri duhet të sigurojë që të ndërpritet mbështetja financiare e specializanteve të cilët janë identifikuar se punojnë edhe në institucione tjera dhe të shqyrtohen mundësitë ligjore për të kërkuar kthimin e mjeteve të përfituara në kundërshtim me kontratat. Po ashtu, në bashkëpunim me ATK dhe Trust-in, të merren masat e nevojshme për të verifikuar në baza mujore nëse specialistët që subvencionohen nga MSh realizojnë të ardhura edhe nga institucione tjera.

Çështja 20 - Subvencionimi i specialistëve të papunë dhe specialistëve, bazuar në kërkesat e Kuvendit të Kosovës - Prioritet i lartë

E gjetura Duke u mbështetur në transkriptin e mbledhjes plenare të Kuvendit të RKS të mbajtur më 14.07.2016, MSh ka filluar subvencionimin e specialistëve të pa punësuar në sektorin publik shëndetësorë dhe specializanteve të cilët ishin në shkollim specialistik me vetëfinancim në institucionet publike dhe ato private shëndetësore. Specialistët ishin angazhuar përmes kontratave për kohë të caktuar, ndërsa specialistët ishin angazhuar përmes aneks kontratave bazuar në UA 09-2013 - për skemën stimulative të profesionistëve shëndetësor. Me kërkesë të ministrisë specialistët kanë nënshkruar deklaratat përmes të cilave pranojnë se nuk do të kenë angazhime tjera. Mirëpo ministria nuk kishte arritur që të verifikonte nëse specialistët përfitonin të ardhura edhe nga

ndonjë institucion tjetër. Ne kemi identifikuar (përmes krahasimit të listës së pagave për muajin dhjetor me sistemin e ATK-së dhe Payrollit) se 51 specializantë gjatë tremujorit 2016 kanë punuar edhe në institucione tjera private/publike (26 prej tyre janë në sektorin publik). Si rezultat, nga përfitimi i specialistëve dhe specializantëve në kundërshtim me marrëveshjet e nënshkuara, buxheti i ministrisë ishte dëmtuar në vlerë prej rreth 70,000€.

Po ashtu, punësimi i specialistëve në sektorin publik shëndetësorë ishte shoqëruar me parregullsi. Qëllimi ishte që specialistët të punësohen në sistemin publik shëndetësor, dhe prioritet ishte punësimi i specialistëve që nuk ishin fare të punësuar. Ne kemi evidentuar se 34 specialistë të cilët janë angazhuar nga MSh, kishin punuar gjatë vitit 2016 në institucionet publike⁵ (15 prej tyre kishin vazhduar të punojnë në institucione publike edhe pas angazhimit në MSh - në institucionet publike kanë realizuar pagë primare derisa në MSh kanë pasur kontrata për kohë të caktuar. Derisa dy të tjerë ishin duke punuar në sektorin publik shëndetësor).

Rreziku

Mungesa e mekanizmave për monitorimin dhe verifikimin e te ardhurave të specializantëve/specialistëve të cilët subvencionohen nga MSh rrezikon të bëhen pagesa në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe si pasojë me dëmtim të buxhetit të ministrisë. Angazhimi i specialistëve në kundërshtim me prioritetet e përcaktuara, rrit rrezikun që specialist të caktuar të përfitojnë nga dy puna derisa të tjerë të mbesin pa u angazhuar fare.

Rekomandimi 20

Ministri duhet të sigurohet se do të ndërpritet mbështetja financiare e specializantëve të cilët janë identifikuar se punojnë edhe në institucione tjera dhe të shqyrtohen mundësitë ligjore për të kërkuar kthimin e mjeteve të përfituara në kundërshtim me kontratat. Po ashtu, në bashkëpunim me ATK-në dhe Trust-in duhet të verifikohet, në baza mujore nëse specializantët që subvencionohen nga MSh realizojnë të ardhura edhe në institucione tjera.

Sa i përket punësimit të specialistëve, duhet të sigurohet që përparësi t'u jepet specialistëve të cilët nuk janë fare të punësuar, derisa specialistët që punojnë edhe në institucione tjera publike duhet të përcaktojnë pagat primare dhe sekondare në pajtim me kërkesat ligjore. Po ashtu, për specialistët të cilët janë identifikuar se punojnë në shërbimet primare shëndetësore, duhet të konsiderohet ndërprerja e marrëveshjeve.

⁵ Jo në institucione publike shëndetësore, por institucione tjera si në shkolla dhe institucione tjera.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 8,791,912€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 7,146,481€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me blerjen e pajisjeve mjekësore, blerjet dhe ndërtimet për organizatat tjera buxhetore, servisim dhe mirëmbajtje etj.

Çështja 21 - Përkrahja për komunitetin Rom Ashkali Egjiptas (RAE) - Prioritet i lartë

E gjetura Në kuadër të projekteve të buxhetuara kapitale të MSh-së përfshihet edhe projekti “Përkrahje e Komunitetit RAE në promovimin dhe qasjen në shërbimeve shëndetësore”. Gjatë vitit 2016 MSh nga ky projekt kishte blerë pajisje në vlerë 14,400€ për Klinikën e Endokrinologjisë në QKUK, aparat biokimik në vlerë 14,900€, si dhe dy (2) karrige stomatologjike në vlerë 17,400€ për QKMF-në në Obiliq, si zonë e populluar me më shumë banorë të komunitetit RAE. Në bazë të Strategjisë për integrimin e komunitetit RAE dhe Planit të veprimit, këto shpenzime nuk janë në përputhje me objektivat dhe aktivitetet e parapara për mbështetjen e këtij projekti nga MSh. Në planin e veprimit për integrimin e komunitetit RAE nuk janë paraparë aktivitete që lidhen me investimet kapitale, prandaj mjetet e dedikuara për këtë projekt janë keq-buxhetuar dhe shpenzuar nga kategoria e investimeve kapitale.

Rreziku Buxhetimi dhe shpenzimi i mjeteve në kundërshtim me strategjinë dhe aktivitetet e parapara në planin e veprimit ndikon në mos përmbushjen e objektivave dhe qëllimit të projektit.

Rekomandimi 21 Ministri duhet të sigurojë që mjetet e dedikuara për projekte të caktuara të buxhetohen dhe shpenzohen në harmoni me strategjinë e projektit dhe aktivitetet e parapara në planin e veprimit, në mënyrë që të përmbushen objektivat dhe qëllimi i projektit.

Çështja 22 - Dobësi në planifikimin e prokurimit dhe raportimin e kontratave - Prioritet i mesëm

E gjetura Planifikimi i aktiviteteve të prokurimit dhe raporti i kontratave të nënshkruar nuk ishin të plota ngase:

- Kontrata “ Vazhdimi i Ndërtimit të Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF) në Bair Mitrovicë - Faza II” në vlerën prej 68,664€ e nënshkruar në muajin qershor të vitit 2016, nuk ishte përfshirë në planin e prokurimit për vitin 2016 dhe nuk ishte përfshirë në raportin vjetor të kontratave të nënshkruara;
- Kontrata “Ndërtimi i klinikës emergjente në QKUK” në vlerë 8,106,239€ e nënshkruar në maj të vitit 2016, nuk ishte raportuar në raportin vjetor të kontratave të nënshkruara. Për më tepër vlera e parashikuar e kësaj kontrate në planin e prokurimit ishte 1,543,895€; dhe
- Për kontratën “Furnizim me aparaturë mjekësore “në QKKTGj, vlera e parashikuar në planin e prokurimit ishte 50,000€, ndërsa vlera e kontratës së realizuar ishte 71,960€. Në mungesë të fondeve të buxhetuara, për pagesë janë shfrytëzuar mjetet edhe nga kodet e projekteve tjera.

Rreziku Mos efikasiteti në planifikimin e aktiviteteve të prokurimit është tregues i kontrolleve jo efektive në fushën e menaxhimit të shpenzimeve përmes prokurimit. Mos raportimi i kontratave të dhëna publike paraqet anashkalim të procedurave ligjore dhe rrit rrezikun për menaxhim jo të mirë dhe jo transparent të shpenzimit të parasë publike.

Rekomandimi 22 Ministri dhe Drejtori i QKKTGj të sigurojnë mekanizma në forcimin e kontrolleve në fushën e prokurimit përfshirë këtu rritje të efikasitetit në planifikimin e aktiviteteve të prokurimit në raport me nevojat dhe buxhetin e disponueshëm. Po ashtu të sigurohet që çdo kontratë e dhënë publike të raportohet në harmoni me kërkesat dhe procedurat e parapara ligjore.

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallra dhe shërbime si dhe investime kapitale

Ne vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me Mallra dhe Shërbime si dhe Investime Kapitale.

Çështja 23 – Mangësi në menaxhimin e kontratave – Prioritet i lartë

E gjetura	<p>Shqyrtimi jonë i mostrave ka nxjerrë në pah mangësitë, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në pesë (5) rastet (në MSh, AKPPM dhe QKKTGj), kemi konstatuar se menaxherët e projekteve emërohen formalisht, por nuk raportojnë rreth menaxhimit dhe realizimit të kontratave, që është përgjegjësi ligjore e tyre nga momenti i emërimit; • Në QKKTGj, kemi hasur një (1) rast ku servisimi i pajisjeve mjekësore kompensohet për orë pune. Pranimi i shërbimit nuk monitorohet/raportohet nga menaxheri i kontratës, ndërsa pagesa bëhet në bazë të raportit të servisimit të përgatitur nga Operatori Ekonomik (OE), ku vet operatori i deklaroi orët e punës të shpenzuara për servisim. Kompensimi për një orë pune përfshinë vlerën 40-50€; • Po ashtu IKShP, për servisimin e pajisjeve laboratorike ishte nënshkruar kontratë kornizë me OE për periudhë tri (3) vjeçare në vlerë prej 24,905€, ndërsa një muaj pas nënshkrimit të kontratës ishte konsumuar 55% e vlerës së saj. Për më tepër mungonin raportet e OE për pajisjet e servisuara dhe evidenca mbi monitorimin dhe konfirmimin e punës së kryer nga Autoriteti Kontraktues. Kompensimi për një orë pune përfshinë vlerën 469,64€; dhe • Për kontratat e nënshkruara për furnizim me barna ne kemi evidentuar se nuk janë caktuar menaxherët e kontratave, të cilët janë përgjegjës për hartimin e planit dhe për të përcjellur mbarëvajtjen e kontratave.
Rreziku	<p>Mangësitë në menaxhimin e kontratave respektivisht mungesa e monitorimit dhe raportimit për realizimin e tyre zvogëlon sigurinë që kontratat janë realizuar konform kushteve dhe specifikave të parapara. Mos planifikimi i dinamikës së shpenzimit mund të rezultojë me mos efikasitet në realizimin e kontratës në raport me mjetet e shpenzuara.</p>
Rekomandimi 23	<p>Ministri dhe Drejtorët e Njësive të MSh-së duhet të sigurojnë respektimin konsistent dhe efektiv të rregullave/procedurave të prokurimit, dhe menaxhimin adekuat të kontratave për të siguruar arritjen e vlerës për parane e shpenzuar në prokurim. Një monitorim sistematik i realizimit të kontratave do të shtonte sigurinë tek menaxhmenti se kontratat po realizohen konform kushteve të kontraktuara.</p>

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Kjo kërkon procedura të kontrollit dhe menaxhimit të cilat vërtetojnë ekzistencën e pasurive dhe sigurojnë të dhëna të sakta dhe të azhurnuara për pasuritë e institucionit.

Vlera neto e pasurive të MSh-së, e shpalosur në PFV ishte 3,288,219€. Prej tyre 2,903,635€ ishin pasuritë më vlerë mbi 1,000€, dhe 384,584€ pasuritë nën vlerën 1,000€.

Ne kemi testuar saldon fillestare, blerjet e vitit duke përfshirë investimet kapitale dhe blerjet për pajisje dhe mobilje nën 1,000€ nga mallrat dhe shërbimet, si dhe rregullsinë në evidentimin dhe inventarizimin e pasurisë në dispozicion. Ne kemi bërë edhe ekzaminimin fizik për të verifikuar ekzistencën e pasurisë.

Çështja 24 - Klasifikim i gabuar i pasurive në regjistrin e pasurisë - Prioritet i lartë

E gjetura Sipas UA për menaxhimin e pasurisë jo financiare, pasuritë kapitale që janë në fazën e ndërtimit dhe të pa finalizuara duhet të regjistrohen në kategorinë e investimeve në vijim dhe nuk duhet të zhvlerësohen. Në IKShP pagesat e situacioneve të kryera për projektet kapitale “Ndërtimi i ISHP në Ferizaj” në vlerë 52,196€ dhe “Ndërtimi i ISHP-së në Gjilan” në vlerë 182,800€ ishin regjistruar në kategorinë e Ndërtesave Administrative dhe ishin zhvlerësuar edhe pse ndërtimi nuk ishte i finalizuar dhe nuk ishte kryer pranimi teknik.

Rreziku Klasifikimi i gabuar i pasurive të regjistruara në regjistrin kontabël ndikon në mosparaqitjen e drejtë të vlerës tyre në pasqyra duke pasqyruar ndikimin e zhvlerësimit dhe normave të ndryshme për klasa të ndryshme të pasurive.

Rekomandimi 24 Ministri dhe Drejtori i IKShP-së të sigurohen që të gjitha pasuritë e institucionit të regjistrohen në klasat e duhura të pasurive konform rregullores dhe legjislacionit në fuqi në mënyrë që vlera e tyre të prezantohet drejtë në PFV.

Çështja 25 – Menaxhim i dobët i pasurive nën 1,000€ - Prioritet i lartë**E gjetura**

Në nivel të MSh-së dhe njësive të saj vazhdon të ketë mangësi në menaxhimin e pasurisë jo financiare nën 1,000€ dhe prezantimin e gjendjes reale të saj në PFV. Këto pasuri nuk ishin zhvlerësuar ashtu siç kërkohet me rregulloren e aplikueshme dhe si rrjedhojë vlerat e prezantuara në PFV nuk paraqesin vlerën e drejtë të tyre.

Në IKShP pasuria jo kapitale dhe stoqet nuk regjistrohen në sistemin e-pasuria ashtu siç parashihet me rregulloren për menaxhimin e pasurive jo financiare. Të dhënat për këto pasuri mbahen në regjistra individuale të IKShP-së dhe nuk përputhen me vlerat e prezantuara të këtyre pasurive në PFV. Ne kemi identifikuar pasuri të paregjistruara që përfshijnë: pajisje të IT-së në vlerë 1,970€; Laura (rampë) për parkingun e IKShP-së në vlerë 991€; peshore laboratorike digjitale në vlerë 680€; pajisje laboratorike në vlerë 7,800€ si dhe centrifugë në vlerë 990€.

Gjithashtu në QKKTGj kemi identifikuar pasuri të paregjistruara në sistemin e-pasuria që është i aplikueshëm në këtë njësi. Këto pasuri përfshijnë: Lavatriqe në vlerë 285€; Videofon në vlerë 90€ si dhe furnizim me inventar në vlerën prej 1,690€.

AKPPM nuk e ka paraqitur fare gjendjen e pasurive nën 1,000€ të institucionit në PFV-të e vitit 2016. Ne kemi identifikuar pasuri të paregjistruara që përfshijnë blerjen e 30 kompjuterëve në vlerën prej 22,400€ prej të cilëve dhjetë (10) janë pranuar në vitin paraprak.

Gjithashtu në programet tjera të MSh-së, përfshirë Administratën Qendrore dhe Kabinetin e Ministrit, kemi identifikuar pasuri të paregjistruara në sistemin e-pasuria të tilla si: Telefon mobil në vlerë 800€; Mobilje në vlerë 950€; dy (2) lap-top në vlerë 1,940€; një (1) kompjuter në vlerë 895€ dhe një (1) printer në vlerë 300€.

Rreziku

Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë, mospërdorimi i sistemit e-pasuria dhe mos aplikimi i zhvlerësimit pengon menaxhimin efektiv të pasurisë jo kapitale dhe stoqeve dhe ndikon në prezantimin jo të drejtë të gjendjes së tyre në pasqyra financiare.

Rekomandimi 25

Ministri dhe Drejtorët e njësive duhet të sigurohen që menaxhimi i pasurisë jo financiare të organizatës të bëhet konform udhëzimeve ligjore si dhe të merren masa në drejtim të trajnimit të stafit dhe funksionalizimit të sistemit e-pasuria aty ku nuk aplikohet. Regjistrat e pasurisë duhet të jenë të plotë, të përmbajnë të gjitha elementet siç përcaktohet me udhëzuesin përkatës si dhe të azhurnohen në vazhdimësi me qëllim të paraqitjes së gjendjes reale të pasurisë në pasqyra financiare.

3.2.2 Të arkëtueshmet

Ministria nuk ka arritur t'i arkëtoj të gjitha te arkëtueshmet për të cilat ka ofruar shërbime. Struktura e llogarive të arkëtueshme përbëhet kryesisht nga: gjobat nga inspektimet e kryera, shpenzimet për shërbimet e gjakut, Inspektimi higjienik sanitar etj.

Çështja 26 - Menaxhimi i të arkëtueshmeve në QKKTGj - Prioritet i lartë

E gjetura QKKTGj ka marrëveshje me klinikat private për shpenzimet e shërbimeve të gjakut. Pjesa më e madhe e te arkëtueshmeve apo rreth 70% vie nga një debitor i cili ka obligime të cilat nuk i ka përmbushur që nga viti 2013. Përderisa në të njëjtën kohë vazhdon të marrë shërbimet e nevojshme nga QKKTGj. Vlen të theksohet se nga analizimi i marrëveshjeve kemi evidentuar se nuk ishin përcaktuar qartë kushtet e pagesave që klinikat private duhet të kryejnë ndaj QKKTGj-së, e as nuk ishin paraparë penale në rast të vonesave në kryerjen e obligimeve. Nga testimet tona ka rezultuar se QKKTGj nuk lëshon faturë në momentin që kryen shërbim ndaj palëve por këtë e bën në çdo fund të muajit për shërbimet e ofruara gjatë muajit përkatës.

Rreziku Mungesa e masave konkrete për të inkasuar llogaritë e arkëtueshme, mund të rezultojë me rritjen e këtyre llogarive. Gjithashtu, kjo redukton edhe fleksibilitetin e Ministrisë ndaj shpenzimeve të planifikuara që financohen nga të hyrat vetjake.

Rekomandimi 26 Ministri duhet t'i analizojë arsyet e trendit të rritjes së këtyre llogarive dhe mos raportimit të saktë të tyre dhe t'i forcojë kontrollet për të parandaluar rritjen e tyre të mëtutjeshme. Duhet të vendosen mekanizma adekuat dhe të shfrytëzohen të gjitha mjetet në dispozicion dhe veprimet ligjore për të mundësuar arkëtimin e borxheve të akumuluar.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 2,501,287€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga MSh dhe është shqyrtuar më në detaje në nënkapitullin 1.3.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.2 Theksimi i çështjes	Ministri duhet të sigurojë se është bërë një analizë gjithëpërfshirëse për ti përcaktuar shkaqet për Theksimin e Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për ti adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe praktike për ti hequr gabimet në klasifikimin e shpenzimeve dhe për të siguruar vlerësimin e saktë të pasurive, stoqeve, detyrimeve dhe të arkëtueshmeve.			Nuk janë marrë masa.
1.4. Pasqyrat Financiare	Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet në lidhje me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PVF janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.			Nuk janë marrë masa.
2.3. Rekomandimet e vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementim e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Ministria ka përgatitur planin e veprimit për zbatim të rekomandimeve të ZKA, por mos adresimi i plotë i rekomandimeve ka rezultuar në vazhdimin e dobësive të njëjta.	
2.4. Lista Kontrolluese e vetëvlerësimit	Ministri duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim i procesit të plotësisht të listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.		Strategjia sektoriale e shëndetësisë është miratuar, është hartuar regjistri i rreziqeve, megjithatë kemi hasur në mangësi të tjera.	

2.5.1 Aranzhimet e llogaridhënies	Ministri duhet të sigurojë një rishikim të kërkesave ekzistuese të llogaridhënies dhe të raportimit ndaj agjencive ekzekutive përfshirë efikasitetin e procesit të konsolidimit si dhe të sigurojë aranzhime të përmirësuara për të arritur objektivat specifike deri më 1 tetor 2016.		Në gjysmën e dytë të 2016 ka filluar të bëhet raportimi nga njësitë në baza javore, po ashtu në sistemin kryesor financiar ka raportim të përmirësuar mbi shpenzimet dhe të hyrat.	
2.5.2 Menaxhimi i Rrezikut	Ministri duhet të sigurojë se është zhvilluar një qasje e re e menaxhimit e cila do të adresonte rreziqet potenciale për mosarritjen e objektivave të MSh-së dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.		Regjistri i rreziqeve është hartuar, por nuk është miratuar nga menaxhmenti.	
2.6 Sistemi i Auditimit të Brendshëm	Ministri duhet të sigurohet që përmbushja e aktiviteteve të planifikuara të NjAB-së të monitorohet çdo tre muaj dhe të ndërmerren veprime proaktive, në mënyrë që devijimet nga plani të adresohen në kohën e duhur. Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i NjAB, Ministri duhet të sigurojë funksionimin efektiv të Komitetit të Auditimit. Gjithashtu duhet të rishikohen veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.	Po.		
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Ministri duhet të sigurojë fillimisht klasifikimin korrekt të shpenzimeve në kërkesat buxhetore në mënyrë që shpenzimet të mund të realizohen dhe të regjistrohen në kategoritë buxhetore adekuate. Kjo mundëson një paraqitje me të qartë në lidhje me natyrën e shpenzimeve të prezantuara në PVF.			Nuk janë marrë masa.
3.4 Prokurimi	Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim i brendshëm për çështjet e identifikuar të prokurimit, në të cilat rregullat dhe udhëzuesit nuk janë aplikuar në mënyrë efektive. Bazuar në këtë rishikim, të ndërmerren masat e nevojshme që mundësojnë shmangien e mangësive të tilla në të ardhmen.		Përkundër rekomandimeve tona nuk kemi vërejtur se kane ndërmarr masa konkrete për menaxhim të kontratave dhe raportimit nga menaxheret e kontratave.	

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Ministri duhet të siguroj që të zbatohen me përpikëri politikat dhe procedurat e kërkuara me rastin e udhëtimeve zyrtare, duke dëshmuar dhe arsyetuar saktë shpenzimet e ndodhura dhe duke mbyllur me kohë avanset.			Nuk janë marrë masa.
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Ministri dhe Kryeshefi ekzekutiv i AKPPM-së duhet të sigurojnë që të gjitha pagesat dhe shpenzimet të realizohen në përputhje me planifikimet paraprake, dhe të regjistrohen konform planit të aprovuar kontabël.			Nuk janë marrë masa.
3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri dhe drejtori i IKSHP-së duhet të sigurojnë që të gjitha pozitat udhëheqëse të ushtrohen me orar të plotë dhe me kontrata të rregullta të punës. Kësaj duhet ti paraprijë konkursi publik i zhvilluar në pajtim me rregullat në fuqi.			Nuk janë marrë masa.
3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri duhet të iniciojë një rishikim gjithëpërfshirës të stafit të angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta për të përcaktuar saktë nevojat për staf në AKPPM, dhe të gjitha pozitat e nevojshme të plotësohen me staf të rregullt, përmes procesit të hapur të rekrutimit.			Nuk janë marrë masa.
3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Pagesat për borde dhe komisione për zyrtarët specifik janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi pasi që nuk lejohet pjesëmarrja në më shumë se një bord apo komision. Kjo mund të shkaktojë pagesa të parregullta dhe dëmtim eventual të buxhetit. Përveç kësaj angazhimi në borde/komisione gjatë orarit të punës rrit rrezikun që zyrtarët të mos i kryejnë obligimet e tyre ditore si rezultat i angazhimit në detyra tjera.			Nuk janë marrë masa.
3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri së bashku me drejtorin e përgjithshëm të ShSKUK-së duhet të shqyrtojnë mundësinë që kompensimi për pagat dhe kujdestaritë e këtyre mjekëve specialist të bëhet nga buxheti i ShSKUK e jo nga Ministria.		Është adresuar pjesërisht. Kujdestaritë nuk i kompenson MSh por këta mjekë vazhdojnë të jenë në listë të pagave të MSh-së.	

3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ministri nëpërmjet drejtorit të QKTGj-së duhet të sigurojë që aplikohen kontrole monitoruese ndaj procesit të planifikimit, aprovimit, evidentimit dhe kompensimit të kujdestarive, në mënyrë që kompensimet të jenë të bazuara në ditaret e kujdestarive. Ndryshimet eventuale të planit duhet paraprakisht të aprovohen.		Ky rekomandim është në proces të zbatimit.	
3.5.3 Subvencionet dhe Transferet.	Ministri duhet të sigurojë që të ndërpritet mbështetja financiare për specialistët e identifikuar që kanë përfituar në kundërshtim me marrëveshjet dhe të shqyrtohen mundësitë ligjore për të kërkuar kthimin e mjeteve të përfituara në kundërshtim me marrëveshjet e nënshkruara. Përveç kësaj duhet të vendoset bashkëpunim me institucionet relevante (ATK dhe Trustin) për të verifikuar nëse ka edhe specialistë tjerë që punojnë/përfitojnë të ardhura në institucione private dhe kanë përfituar subvencionim nga MSh.		Ministria ka marr hapa ne këtë drejtim mirëpo nuk ishin te mjaftueshëm pasi dhe gjate kësaj faze kemi hasur specialist te cilët punojnë dhe ne institucione tjera publike.	
3.5.3 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të sigurohet se subvencionet paguhen pas nënshkrimit të një marrëveshje formale në mes të MSh-së dhe përfituesit, ku qartësohen obligimet e të dy palëve. Gjatë zhvillimit të procedurave të aplikimit dhe shqyrtimit të tyre duhet të respektohen kërkesat ligjore. Përveç kësaj Ministri duhet të iniciojë krijimin e një rregullore/udhëzimi për të përcaktuar përgjegjësitë e MSh dhe marrëdhëniet me institucionet shëndetësore private duke specifikuar në mënyrë të qartë kërkesat për raportim financiar dhe në lidhje me shërbimet e ofruara.			Nuk janë marrë masa.
3.5.3 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të shqyrtoj mundësinë e krijimit të një mekanizmi adekuat që do të siguronte se barnat e subvencionuar kanë arritur tek pacientët e synuar. Po ashtu Ministri së bashku me AFSH-në duhet të shtojnë kontrollet për të siguruar që kontratat për furnizim me barnat e LE menaxhohen në mënyrë efektive dhe që të ketë furnizim të rregullt me barna nga LE.		Ministria ka marr hapa për adresim te këtij rekomandimi, por nuk është i plote ngase kemi pa raste ku ministria ka subvencionua barna te cilat janë pjese te listës esenciale.	

3.5.3 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të siguroj që programet e subvencionuara të jenë subjekt i monitorimit të rregullt nga zyrtarët e Ministrisë, për të siguruar respektimin e kërkesave për raportimin e mënyrës së shfrytëzimit të mjeteve. Po ashtu, mos të vazhdojë subvencionimi i shoqatave profesionale për EVM përdërisa nuk i arsyetojnë shpenzimet e mjeteve financiare të përfituara nga MSh.			Nuk janë marrë masa.
3.6 Të hyrat	Ministri duhet të sigurojë që të funksionalizohet moduli për të hyra në kuadër të Sistemit Informativ Shëndetësor (SISh), i cili do mbështeste mbledhjen dhe menaxhimin e të hyrave. Po ashtu, Kryeshefi i AKPPM-së duhet të sigurohet që regjistrat e brendshëm për të hyrat të jenë të sakta dhe të harmonizohen me SIMFK-në. Kjo do të mundësonte shpalosjen e informatave të sakta në PVF.			Nuk janë marrë masa.
3.7 Pasuritë dhe detyrimet	Ministri duhet të iniciojë një rishikim për të përcaktuar pse rregullat dhe procedurat e nevojshme për menaxhimin e pasurisë, nuk janë aplikuar dhe të përcaktojë masat e nevojshme për menaxhimin më mirë të tyre . Regjistrat e pasurisë duhet të azhurnohen në vazhdimësi për të siguruar shpalosjen e vlerës së tyre të saktë në PVF.		Ministria ka marr masa për adresimin e plotë të këtij rekomandimi, është vendosur zyrtari pranimi, është bërë regjistrimi i pasurive fikse, por, është vështirë të përcaktohet nëse regjistri është i plotë.	
3.7.2 Menaxhimi i Barnave	Ministri duhet të kërkojë një rishikim të kualitetit të informatave rreth stokut farmaceutik dhe mënyrës së përdorimit të SMSF-së, për të përcaktuar masat e nevojshme për përmirësimin e menaxhimit të tij. Sigurimi i informatave të sakta të stokut farmaceutik mundëson menaxhim më të lehtë dhe eviton mundësinë e theksimit të çështjes ose modifikimit të opinionit për PVF.			Nuk janë marrë masa.

3.7.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Ministri duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim gjithëpërfshirës sa i përket qasjes ndaj llogarive të arkëtueshme duke i identifikuar pengesat në përmirësimin e shkallës së mbledhjes së të hyrave. Duhet të mbahen evidenca të sakta në lidhje me llogaritë e arkëtueshme dhe informatat nga këto evidenca të shpalosen në PVF.		Ministria ka marr masa përmes përmbauesit privat për të realizuar të hyrat e pa mbledhura dhe është vërejtur përmirësim. Por në disa njësi nuk është adresuar në masë të plotë.	
3.7.4 Trajtimi i borxheve	Ministri duhet të iniciojë një rishikim të gjendjes së detyrimeve, për të përcaktuar shkaqet e vonesave dhe masat e nevojshme për adresimin e kësaj çështje. Vlerësimi i detyrimeve duhet të bëhet në baza të rregullta mujore, dhe pagesat të bëhen sipas limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare.			Nuk janë marrë masa.

Shtojca IV: Letër e konfirmimit

			
			
Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo Qeveria - Vlada - Government Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva – Ministry of Health			

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

¹ Z. Ardian Mehmetaj,

Sekretar i Përgjithshëm i MSH-së

Data: 29 qershor 2017, Prishtinë

